

U D H Ë Z I M
Nr. 7, datë 14.8.2002

PËR ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË ADRESAVE NË QYTETE

Në mbështetje të pikës 4 neni 102 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, për të lehtësuar plotësimin e kompetencës së bashkive dhe komunave, në përputhje me nenin 32 pika 11 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin e funksionimit të qeverisjes vendore", për t'iu përgjigjur ndryshimeve të mëdha në urbanistikë, sidomos në qytete, për të lehtësuar shërbimin e gjendjes civile dhe shërbimeve të tjera publike,

U D H Ë Z O J:

1. Të studiohet gjendja e emërtimeve të rrugëve dhe të shesheve publike të qytetit dhe të procedohet me përcaktimin e emrave të të gjitha rrugëve e shesheve që nuk janë të emërtuara.
2. Të bëhet përcaktimi në planimetri i numrave të pallateve, banesave, të shkallëve dhe të apartamenteve.
3. Të publikohen vendimet e këshillave vendore për emërtimet e rrugëve dhe shesheve të reja, si dhe planimetria e aktualizuar e qytetit, e cila duhet t'u dërgohet zyrtarisht për dijeni e veprime institucioneve të interesuara, në mënyrë të veçantë zyrave të gjendjes civile, komisioneve të zgjedhjeve të qeverisjes vendore (KZQV-së) dhe prefekturave.
4. Brenda mundësive financiare të bashkive, të punohet për vendosjen në terren të tabelave me emërtimet e rrugëve, shesheve, numrat e pallateve e të shkallëve, në ratet kur ato mungojnë ose kanë nevojë të rinovohen.
5. Të stimulohet hartimi i guidave të qyteteve me emrat e rrugëve e të shesheve të shkruara qartë, si dhe me shpjegimet përkatëse.
6. Në bashkitë e mëdha të studihet mundësia e hapjes së "Zyrës së adresave", si një institucion që përmbledh informacionin për gjendjen dhe ndryshimet e adresave në proces, duke përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.
7. Të bëhet bilanci i shpenzimeve që duhen kryer për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe, në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë, t'i propozohet këshillit bashkiak angazhimi i fondeve në këtë proces për vitin buxhetor në vazhdim dhe për vitin 2003.
8. Problemet e paraqitura në pikat 1 deri 3 (përfshirë) duhet të realizohen brenda vitit 2002, ndërsa problemet e tjera të plotësohen në raport me mundësitë financiare që krijohen, në bazë të përcaktimit të fondeve nga këshilli i bashkisë.

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT
Ben Blushi